



S T A T U T I

I TEATRIT PROFESIONIST TË QYTETIT TË GJILANIT

Gjilan, Prill 2011

Në pajtim me dispozitat e neneve 12 pika b, 45, 46 dhe 50 pika b të Ligjit për Teatër Nr. 02/L-12/2005, të Ligjit për Institucionet e Kulturës Nr. 02/L-57/2006, nenit 12 pika d) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 28/2008) nenit 39.2 të statutit të Komunës së Gjilanit 01. nr. 12480 të datës 21.11.2008, Kuvendi i Komunës së Gjilanit, në mbledhjen e vetë të mbajtur me 27.04.2011miraton:

S T A T U T I N

E Teatrit Profesionist të Qytetit të Gjilanit

KREU I

Dispozitat e Përgjithshme

Themelimi, Emërtimi dhe Selia

Neni 1

Me këtë statut rregullohet statusi juridik, veprimtaria, organizimi i brendshëm, organi drejtues, organet ekzekutive, përfaqësimi dhe transparenca e Teatrit Profesionist të qytetit të Gjilanit (në tekstin e mëtejme: TPQGJ).

Neni 2

TPQGJ veprimtarinë, të drejtat dhe përgjegjësitë e veta i realizon në pajtim me dispozitat e ligjit për Teatrin, statutit dhe akteve tjera nënligjore.

Neni 3

TPQGJ veprimtarinë e vetë e zhvillon prej vitit 1954 në Gjilan.

Neni 4

4.1. Emërtimi i teatrit është: “Teatri Profesionist i Qytetit të Gjilanit” në Gjilan, ndërsa emërtimi i shkurtë është: “TPQGJ”.

4.2. TPQGJ selinë e ka në Gjilan, Sheshi “Agim Ramadani” p.n.

Neni 5

TPQGJ ka status të personit juridik.

Neni 6

6.1. TPQGJ ka vulën e rumbullakët dhe vulën katrore.

6.2. Vula e rumbullakët është me përmasa të diametri 40 mm dhe ka këtë përmbajtje:

- a) rrethi i jashtëm – Republika e Kosovës;
- b) rrethi i dytë – Komuna e Gjilanit, Gjilan
- c) rrethi i tretë – Emërtimi i Teatrit.
- d) në mes të vulës do të jetë emblema e Teatrit.

6.3. Vula e protokollit është e përmasave 35 x 70 mm dhe ka këtë përmbajtje:

- a) Rrethi i parë – Republika e Kosovës;
- b) Rrethi i dytë – Komuna e Gjilanit, Gjilan
- c) Rrethi i tretë – zbrazëtira për shifrën e teatrit, në gjatësi prej 10mm, shkronjat “Nr.” zbrazëtirën për shifrën e përmbajtjes së aktit dhe shifrës së numrit në gjatësi prej 30 mm si shkronjat “Më” me zbrazëtirë për shënim të datës së pranimit në gjatësi prej 25mm.

6.4. Teksti i vulave shkruhet në gjuhët zyrtare.

6.5. Teatri ka logon e vet dhe përmban: dy maskat e teatrit (në të kuqe) ballë për ballë njëra tjetrës me ndërtesën shumë kafshe në sheshin “Agim Ramadani” (në të hirtë me prapavijë të verdhë) në mes, ku mbi këto është një kupolë në formë plisi (në të bardhë), ndërsa poshtë këtyre në një shirit (në të hirtë të mbyllur) gjendet shkurtesa TPQGJ.

Veprimtaria e teatrit

Neni 7

Teatri është institucion publik kulturor i artit teatror.

Neni 8

8.1. Teatrit ushtron këto veprimtari:

- a) vlerësimin dhe vendimmarrjen për të nxitur, mbështetur dhe realizuar veprimtarinë teatrore brenda institucionit;
- b) menaxhimin e infrastrukturës së gjithëmbarshme të objektit në pronësi të saj sipas vendimit të KK-Gjilan si dhe menaxhimin dhe mbikëqyrjen e stafit që ka marrëdhënie kontraktuale me Teatrin;
- c) zotësi juridike për të lidhur kontrata dhe për të hyrë në marrëdhënie detyimore me palët për realizimin e veprave dhe aktiviteteve tjera teatrore;
- d) realizon repertorin e verifikuar artistik dhe të qëndrueshëm të shfaqjeve teatrore dhe aktiviteteve tjera të fushës së teatrit.
- e) bashkëpunon me autoritetet publike si dhe me institucionet, organizatat dhe asociacionet vendore dhe të huaja në të gjitha çështjet me interes për zhvillimin e teatrit, shkëmbimin e përvojave dhe informacioneve, për krijimin e ambientit për zhvillimin dhe avancimin e jetës teatrore në Kosovë;
- f) bashkëpunon me institucionet homologe të vendeve të tjera, bashkëpunon dhe aderon në organizatat dhe asociacionet rajonale e ndërkombëtare nga fusha teatrore, si dhe merr pjesë në aktivitetet e tyre, e veçanërisht në festivale, konferenca, trajnime, dhe lloje tjera shkëmbimesh;
- g) zbaton politikat kombëtare në fushën e artit skenik.

8.2. Teatri obligohet të realizojë së paku pesë premiera teatrore gjatë një viti kalendarik, respektivisht gjatë sezonit teatror, si dhe organizimin e së paku 120 shfaqjeve (reprizave) brenda vitit kalendarik;

KREU II

Struktura dhe funksionimi i Teatrit

Neni 9

9.1 Struktura drejtuese ekzekutive e Teatrit përcaktohet me këtë statut, në pajtim me nenin 38, të Ligjit për Teatrin në Kosovë.

9.2 Organet drejtuese dhe vendimmarrëse të Teatrit janë:

- Këshilli Drejtues,
- Drejtori i Përgjithshëm dhe
- Drejtori Artistik.

Këshilli Drejtues

Neni 10

10.1. Këshilli Drejtues i Teatrit është organ i pavarur drejtues që mbikëqyrë punën e menaxhmentit të Teatrit.

- a) hartimin dhe aprovimin e politikave afatgjata të zhvillimit të Teatrit, duke përfshirë politikën artistike, aktiviteve tjera teatrore si dhe bën zgjedhjen strukturës udhëheqëse të teatrit të bazuar me Ligjin për Teatër;
- b) aprovon buxhetin dhe programin vjetor artistik për teatrin si dhe ka qasje në dokumentacionin e rregullt dhe llogaridhënien;
- c) zgjedh udhëheqësit e lartë ekzekutiv të teatrit me konkurs publik dhe me mandat tre vjeçar: drejtorin e përgjithshëm dhe drejtorin artistik të cilat ia propozon kryetarit të Komunës së Gjilanit për miratim;
- d) së paku një herë në vit, mund të fton një auditor të pavarur me kualifikime të dëshmuara për të mbikëqyrur llogarimbajtjen dhe performancën e menaxhmentit të Teatrit;
- e) Përcjell dhe vlerëson ecuritë e realizimit si dhe propozon masat për realizimin e programit vjetor;
- f) shqyrton dhe miraton raportin vjetor menaxhues dhe artistik të Teatrit;
- g) bën emërimin e jurive profesionale për aktivitete të caktuara artistike me propozimin e drejtorit Artistik;
- h) nxjerrë statutin dhe rregulloret e punës së Teatrit;
- i) vlerëson efektivitetin e organizimit të shërbimit profesional të Teatrit;
- j) shqyrton ankesat e parashtruara nga palët kundër vendimeve të menaxhmentit të Teatrit;

10.2. Këshilli Drejtues me 2/3 e votave inicion procedurën e shkarkimit të udhëheqësve ekzekutiv të Teatri (drejtorit të përgjithshëm dhe drejtorit artistik).

10.3. Këshilli Drejtues inicion procedurën e shkarkimit në rast se:

- a) papërgjegjësisë në kryerjen e punës dhe përmbushjes së detyrave;
- b) shkeljet e rënda të dispozitave ligjore dhe statusore gjatë punës;
- c) dëmtimin e imazhit të Teatrit;
- d) veprave penale;
- e) performancën e dobët gjatë punës dhe

Përbërja e Këshillit Drejtues

Neni 11

11.1 Këshilli Drejtues i Teatrit përbëhet nga shtatë anëtarë me mandat tre vjeçar, të cilët emërohen me vendim të Kryetarit të Komunës.

11.2 Këshilli Drejtues i përgjigjet kryetari të Komunës së Gjilanit.

11.3 Anëtarët e Këshillit Drejtues duhet të jenë njohës të mirë të kësaj fushe.

11.4 Kryetari i Këshillin Drejtues zgjidhet në seancën e parë.

11.5. Mënyra e zgjedhjes së kryetarit të Këshillit Drejtues përcaktohet me rregulloren e punës së Këshillit Drejtues.

11.6. Me punën e Këshillit Drejtues udhëheq kryetari i Këshillit Drejtues.

11.7. Në mbledhjet e Këshillit mund të marrin pjesë drejtori artistik dhe Drejtori i përgjithshëm pa të drejt vote.

11.8. Anëtarët e Këshillit Drejtues për punën e tyre kompensohen në përputhje me ligjet dhe rregulloret në fuqi.

Drejtori i Përgjithshëm i Teatrit

Neni 12

12.1. Drejtori i përgjithshëm është përgjegjës:

- a) përpilimin e buxhetit vjetor dhe prezantimin e tij para Këshillit për aprovim;
- b) përgatitjen e aplikacioneve për mbështetje financiare nga burimet publike;
- c) dorëzimin e aplikacioneve dhe propozimeve për mbështetje nga fondacionet humanitare dhe burimet e biznesit;
- d) monitorimin e të hyrave dhe të dalave në pajtim me buxhetin;
- e) siguron mbarëvajtjen e punëve në Teatër nëpërmjet një strukture administrative të duhur;
- f) negocion dhe nënshkruan kontratat me të punësuarit e Teatrit dhe autorët e pavarur siç janë: shkrimtarët, regjisorët, aktorët etj;
- g) negocion kontrata për vizitat (turnetë) brenda dhe jashtë vendit;
- h) mbikëqyrë marketingun dhe promovimin e Teatrit;
- i) mbikëqyrë shitjen e biletave;
- j) mbikëqyrë menaxhimin efikas të ndërtesës duke përfshirë edhe kujdesin ndaj klientëve, përkatësisht spektatorëve dhe
- k) ushtron edhe aktivitete tjera shtesë që lidhen me punën e teatrit në pajtim me ligjin sipas autorizimit të Këshillit Drejtues.
- l) përfaqëson teatrin brenda dhe jashtë vendit;
- m) i raporton këshillit drejtues dhe kryetarit të komunës sipas nevojës.

12.2. Drejtori i përgjithshëm për punën dhe detyrat e tij i përgjigjet Këshillit Drejtues dhe Kryetarit të Komunës.

12.3. Drejtori i Përgjithshëm i Teatrit duhet të ketë kualifikimin superior nga fusha e teatrit ose nga fusha e menaxhimit kulturor në rast se ndryshe nuk është përcaktuar me ligj ose akte nënligjore.

Neni 13

Në mungesë të drejtorit të përgjithshëm nga puna, atë e zëvendëson drejtori artistik i teatrit.

Drejtori Artistik

Neni 14

14.1. Drejtori Artistik është përgjegjës:

- a) përpilimin e repertorin vjetor në pajtim me politikën artistike të aprovuar nga Këshilli;
- b) përzgjedhjen, përpilimin dhe klasifikimin e projekteve teatrore nga pikëpamja cilësore e kulturore;
- c) i propozon Këshillit Drejtues miratimin e projekteve artistike duke përfshirë festivalin e dramës “Talia e Flakës” që është organizatori kryesor i saj;
- d) bën propozimin e aktorëve që i bashkëngjiten ansamblit dhe bën ndarjen e roleve për produksione të veçanta;
- e) përzgjedh listën shkrimtarëve, regjisorëve, skenografëve, disenjatorëve etj.
- f) bashkëpunon me artist ndërkombëtarë të Teatrit;
- g) përzgjedh dhe përmbledh materialin dhe artistët që kanë për qëllim prodhimin artistik dhe i miraton vendimet finale të produksionit;
- h) zhvillon programin dhe strategjinë zhvillimore artistike dhe mbikëqyr të gjithë misionin dhe krijimin artistik (provat) dhe pjesët tjera teknike që lidhen me krijimet artistike;
- i) për zëvendësimin apo lirimin e regjisorit nga përgatitja e pjesës teatrore dhe e merr udhëheqjen e drejtpërdrejt të procesit artistik dhe
- j) shtron edhe aktivitete tjera shtesë që lidhen me punën e teatrit në pajtim me ligjin sipas autorizimit të Këshillit Drejtues.
- k) është përgjegjës për vizionin artistik dhe edukativ, konceptualizimet, udhëheqës dhe realizues – producent i punës së institucionit që përfshinë punën e Teatrit për të rritur, Teatrin për të rinjë dhe për fëmijë, turnet dhe festivalet dhe “Talian e Flakës”
- l) udhëheqë audicionet dhe proceset e intervistimeve dhe
- m) Bashkëpunon me drejtorinë e përgjithshëm në çështje: në prodhimin e planeve strategjike të qëndrueshme dhe në planet e punës vjetore, zbatojnë rishikimet e stafit dhe sistemeve të zhvillimit të teatrit.

14.2. Drejtori artistik për punën e tij i përgjigjet Këshillit Drejtues të Teatrit.

14.3. Drejtori Artistik i Teatrit duhet të ketë kualifikimin superior të arteve skenike.

Njësitë organizative

Neni 15

15.1 Në kuadër të Teatrit veprojnë:

- a) Njësia e Artistike;
- b) Shërbimi i Teknikës dhe

c) Shërbimi i Përgjithshëm Administrativ.

15.2 Njësia Artistike përfshin Ansamblin rezident dhe artistët tjerë kreativë të teatrit siç janë: aktorët, regjisorët, dramaturgët, skenografët, kostumografët, kompozitorët, disenjatorët e dritave etj.

15.3 Shërbimi i Teknikës përshin stafin teknik të Teatrit, që angazhohen në realizimin teknik të shfaqjes dhe është i lidhur drejtpërdrejt me punët në skenë siç janë: inspicientët, dekoratorët, rekuizitorët, kabllomanët, tonistët, grimerët, garderobierët dhe punëtorët tjerë teknik.

15.4 Shërbimi i Përgjithshëm Administrativ përfshinë administratën dhe shërbimet tjera të Teatrit siç janë: juristi, menaxheri, ekonomisti, organizatori, asistenti/ja administrativ/e, bibliotekisti, arkivisti, biletashitësi, furnizuesi, pjesëtarët e sigurimit të objektit, pastruesit dhe stafi tjetër ndihmës në shërbimet e përgjithshme.

15.5. Me rregulloren për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës më hollësisht rregullohet organizimi i brendshëm i teatrit, të drejtat, përgjegjësitë dhe përshkrimi i vendeve të punës të punësuarve në teatër.

Ansamblu Rezident

Neni 16

16.1 Teatri ka Ansambël Rezident, të përbërë prej më së paku 20 aktorë cilësorë, të të gjitha gjeneratave.

16.2 Me këtë ansambël Teatri realizon plan programin e paraparë artistik.

16.3 Me propozim të Drejtorit Artistik, mund të angazhohen edhe aktorë tjerë me kontratë mbi vepër në projekte të caktuara.

10.4 Ansamblin e përhershëm e përzgjedh Komisioni Profesional i përbërë nga 5 anëtarë: dy prej tyre i cakton Teatri dy themelues (Komuna e Gjilanit) dhe një anëtar i jashtëm nga fusha e teatrit.

KREU III

Financimi i Teatrit

Neni 17

17.1 Mjetet për punën e Teatrit sigurohen nga:

- a). buxheti i Komunës së Gjilanit dhe MKRS-së;
- b). të hyrat vetanake, të realizuara nga veprimtaria e teatrove;
- c). testamenti, sponsorët, dhuratat dhe të hyrat tjera.

17.2 Për administrimin e aseteve financiare zbatohet legjislacioni në fuqi për Teatër.

17.3 Në përputhje me legjislacionin në fuqi, Teatri mund të krijojë të ardhura nga shitja e të drejtave të pronësisë mbi aktivitetin artistik, dhe nga çdo lloj aktiviteti tjetër i lejuar me ligj.

KREU IV

Rregulloret e brendshme të Teatrit

Neni 18

18.1 Për organizimin dhe mbarëvajtjen e punës dhe veprimtarisë së Teatrit, drejtori i përgjithshëm në bashkëpunim me drejtorin artistik inicion hartimin e rregulloreve të brendshme të Teatrit të cilat i aprovon Këshilli Drejtues.

18.2 Me rregulloret e brendshme të Teatrit përcaktohen rregullat, kompetencat, funksionimi i njësive, përshkrimet e detyrave të punës për punonjësit e Teatrit, masat administrative etj, nëpërmjet së cilave ushtrohet aktiviteti i përgjithshëm i Teatrit.

18.3 Numri i rregulloreve përcaktohet nga ana e drejtorit përgjithshëm varësisht prej nevojave dhe kërkesave që ka puna në Teatër.

18.4 Rregulloret bazike miratohen brenda gjashtë muaj (6) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij Statuti.

Punonjësit e Teatrit

Neni 19

19.1 Të gjithë punonjësit e Teatri i nënshtrohen ligjeve në fuqi dhe zbatimit të statutit dhe rregulloreve për punën e Teatrit;

19.2 Punësimi në Teatër bëhet me kontratë individuale pune në përputhje me legjislacionin e Kosovës në fuqi dhe akteve normative të Teatrit.

19.3 Drejtori i Përgjithshëm i Teatrit përfaqëson në cilësinë e titullarit në krijimin, modifikimin dhe ndërprerjen e marrëdhënieve të punës.

19.4 Të ardhurat e punonjësve të Teatrit përfitohen nga paga dhe shpërblimet që i lejon legjislacioni në fuqi për aktivitetin artistik dhe administrativ të këtij institucioni.

19.5 Punonjësit e Teatrit me kontratë të rregullt pune nuk mund të kryejnë aktivitete të tjera fitimprurëse pa marrë më parë miratimin me shkrim të Drejtorit të Përgjithshëm të Teatrit.

19.6 Të punësuarit në Teatër, të cilëve nuk iu vazhdohet kontrata e re për punësim, njoftohen për këtë më së voni tre muaj para skadimit të afatit të kontratës, përpos në rastet a shkeljet e rënda që janë në përputhje me legjislacionin në fuqi.

19.7. Për të gjitha punësimet në teatër duhet siguruar buxhet dhe më pas koordinim me Drejtorinë për Rini, Kulturë dhe Sport të Komunës së Gjilanit.

Lënda Arkivore dhe Biblioteka e Teatrit

Neni 20

20.1 Teatri ka arkiven dhe bibliotekën e saj .

20.2 Veprimtaria e arkivit dhe bibliotekës së teatrit rregullohet me ligj dhe akte nënligjore.

20.3. Teatri mund të ketë kolanën e vet të botimeve për botimin e veprave dramatike të autorëve vendorë dhe atyre ndërkombëtarë, për hulumtimin shkencor dhe dokumentues-historik në fushën e dramës dhe teatrit, botimin e katalogëve etj.

KREU V

Dispozitat kalimtare

Hyrja në fuqi

Neni 21

21.1 Ky Statut hartohet nga Këshilli Drejtues i teatrit dhe miratohet nga Kuvendi i Komunës së Gjilanit dhe hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit Komunal të Gjilanit.

21.2 Statuti ndryshohet dhe plotësohet, në të njëjtën mënyrë siç është miratuar.

Neni 22

Në rast se dispozitat e këtij statuti mund të jenë në kundërshtim me dispozitat e ligjit për Tetarin , epërsi kanë dispozitat ligjore.

Neni 23

Ky statut hynë në fuqi në ditën e miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Gjilanit.

01.Nr. 16/5680
Gjilan, më 27.04.2011

Kuvendi i Komunës,

Izmi ZEKA, Kryesues